



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2951/2 prot.,

Datë 30.11.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “*Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin*” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.
- Ankimues:** “AIDA CONSTRUCTION” SHPK, me NUIS M03116403L, me adresë: Rr. “BRIGADA XI SULMUESE”, L. APOLONIA, pallati ne krah te Drejtorise Rajonale te Tatimeve, Fier
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kurbin me adresë: Lagjia Nr.3, Laç

Në datën 23.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2951/2023 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3646 e operatorit ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “*Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia*

Kurbin” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “AIDA CONSTRUCTION” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “AIDA CONSTRUCTION” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2951 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon: I. OE nuk plotëson pikën 2.4.3 të DST, si më poshtë: 2.4.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzojë analizë teknike të çmimeve për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mos paraqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. KVO konstatoi se: OE “AIDA CONSTRUCTION” SHPK, nuk plotëson kriterin e mësipërm, pasi nuk ka paraqitur analiza teknike të çmimeve për të gjithë zërat e preventivit të ofertës (sipas VKM Nr. 629, datë 15.7.2015), si dhe ka mospërputhje, çmimi i përcaktuar në analizë me çmimin e vendosur në preventiv. Sqarojmë se, KVO pasi verifikoi Analizat Teknike që OE ka paraqitur në SPE si dhe Preventivin, konstatoi se ka mangësi për sa më poshtë vijon: 1. OE nuk ka paraqitur fare analizë teknike çmimi për zërat e preventivit si më poshtë: - Ndricues tavanor fluoreshent 1x40w (zë i cili

është parashikuar në objektet, III, IX, XIII, XVI). 2. Për zërin: “F.V WC alla frenga importi” ka çmim të ndryshëm preventivi me analizën teknike, ku sqarohet se ky zë në preventiv ka çmimin 6,800 ndërsa në analizë 8600 (ky zë është në shtatë objekte, konkretisht tek II, VII, VIII, IX, X, XII, XV). 3. I njëjti zë në preventiv ka çmim ndryshe në objektin I & II, konkretisht Zëri: “Boje vaji mbi sipërfaqe te patinuar”, zë i cili në një objekt ka çmim 85, ndërsa tek objekti tjetër 100, ndërsa në analizë ka çmim 85.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 30.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri